



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr././0 prot.

Kamëz, më 7.12.2025

V E N D I M
Nr. 92 .Datë 7.12.2025
MBI

**“KOMPENSIMIN E BILETËS SË PAJTIMIT MUJOR, TË PËRGJITHSHËM
(ABONESË SË STUDENTIT) PËR STUDENTËT E PAJISUR ME KARTË STUDENTI
PËR TË GJITHA LINJAT, NË TRANSPORTIN QYTETAS NË BASHKINË KAMËZ”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 17.12.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.81 Datë 10.12.2025 në zbatim të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, nenit 100, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 85, datë 08.02.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”, të ndryshuar, vendimit nr. 226, datë 17.04.2019 të Këshillit të Ministrave, “Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”, udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2019, të ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit”, marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Bashkisë Kamëz “Për ofrimin e shërbimeve me çmime të reduktuara për përfituesit e kartës së studentit, si dhe delegimin dhe administrimin e kartës të studentit nga Bashkia Kamëz”, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e kompensimit të plotë të biletës së pajtimit mujor, të përgjithshëm për studentët e pajisur me kartë studenti për të gjitha linjat, në transportin qytetas në Bashkinë Kamëz për periudhën Janar - Qershor dhe Tetor – Dhjetor, të vitit kalendarik përkatës.
2. Efektet financiare të këtij vendimi do të përballohen nga Buxheti i Bashkisë Kamëz sipas strukturës buxhetore Gr. 0, Progr. 4130, Kap. 5, Art. 602.
3. Numri i aboneve të studentit që do të rimbursohen përcaktohet nga gjenerimi i raportit të sistemit elektronik të kartave të studentit.
4. Kompensimi ndaj operatorëve të licencuar në transportin publik qytetës në Bashkinë Kamëz bëhet nga Bashkia Kamëz sipas volumit të aboneve të shitura për secilin operator.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

5. Operatorët dorëzojnë çdo muaj pranë Bashkisë Kamëz, dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Numri i NIPT- it;
 - b. Numri i Licencës;
 - c. Shuma për t'u paguar;
 - d. Numrin e llogarisë bankare;
 - e. Faturën tatimore.
6. Mënyra e rakordimit do të përcaktohet në marrëveshjen që do të lidhet ndërmjet operatorëve dhe Bashkisë Kamëz.
7. Të shfuqizojë Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 14, datë 22.01.2024.
8. Ngarkohen për zbatim Drejtoria e Licensave dhe Transportit, Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit, Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike dhe Drejtoria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit.
9. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

